

PREZANTIMI I PROJEKTIT

Projekti "Konsolidimi i Gjykatës Rajonale të Apelit - një rishikim i ndikimit të saj në efikasitetin dhe cilësinë e gjyqësorit" zbatohet nga Instituti për Studime Publike dhe Ligjore (ISPL) në kuadër të një marrëveshjeje financimi me Programin Matra të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës.

Ky projekt tre-vjeçar synon të përmirësojë efikasitetin e performancës së Gjykatës së Apelit të Shqipërisë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë saj, pas shkrirjes së gjashtë gjykatave të mëparshme të apelit në një të vetme, në respekt të plotë të legjislacionit mundësues dhe cilësisë së standardeve të drejtësisë.

Dy objektiva të matshme do të synohen gjatë zbatimit të projektit në mënyrë që efekti i tyre kumulativ të mund të çojë në përmbushjen e qëllimit të sipërcituar:

1. Identifikimi i arritjeve dhe problemeve në performancën e Gjykatës së Apelit dhe Prokurorisë pranë saj, për sa i përket efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë.
2. Analizimi dhe sugjerimi i zgjidhjeve adekuate, në bashkëpunim me Gjykatën e Apelit dhe Prokurorinë pranë saj, si dhe me institucionet dhe palët e tjera të interesuara, për të adresuar problemet e identifikuar në drejtim të efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë.

Projekti, fillimisht, do të procedojë me një vlerësim tërësor të nevojave përpara se të hidhet në propozimin e masave dhe zgjidhjeve për zgjidhjen e problemeve të identikuara të performancës për sa i përket efektshmërisë dhe cilësisë së drejtësisë. Ky ushtrim i vlerësimit të nevojave do të përsëritet gjashtë herë gjatë tre viteve rresht të projektit, në mënyrë që evolucioni i situatës të pasqyrohet siç duhet, çështjet dhe problemet të identifikohen në kohë dhe sugjerimet për përmirësime mund të formulohen në raportet e vlerësimit të përbashkëta dhe të diskutuara me grupet e synuara dhe palët e tjera të interesuara.

Vlerësimi i performancës së Gjykatës së Apelit dhe Prokurorisë, si dhe sugjerimet për përmirësimin e saj do të përfshijnë faktorët e mëposhtëm: buxhetin e Gjykatës së Apelit dhe prokurorisë; numrin e rasteve të gjykuara dhe kostot e lidhura me to; efektivitetin (shpejtësinë e procesit gjyqësor) dhe cilësinë (numri i vendimeve të rrëzuara, zbatimi i vendimeve); efikasitetin dhe produktivitetin (ecuria e rasteve, norma e evadimit, koha e disponimit, çështjet në pritje), respektimin e aksesit në drejtësi, standardet e procedurës së rregullt dhe transparencës, etj.

Gjashtë (6) Raportet e Vlerësimit do të përgatiten nga ekipi i ekspertëve të projektit çdo gjashtë muaj dhe gjashtë (6) Fokus Grupe do të zhvillohen për t'i diskutuar ato me grupet e

synuara të projektit (Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria pranë saj, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë) dhe palët e tjera të interesuara.

Përveç kësaj, tre (3) focus grupe me një përfaqësim të avokatëve dhe dy (2) focus grupe me zyrën e Avokatit të Shtetit do t'i shtojnë vlerë analizës së performancës së gjykatës/prokurorisë dhe sugjerimeve për përmirësim.

Së fundi, informacioni i mbledhur nëpërmjet një interviste të strukturuar me një përzierje prej 28 gjyqtarësh/prokurorësh në nivel apeli dhe një sondazh me 1500 përdorues të Gjykatës së Apelit do të ushqejnë më tej punën vlerësuese të ekipit të ekspertëve të projektit.

Raportet e vlerësimit do të shqyrtojnë informacionin e mbledhur nga: raportet institucionale të Gjykatës së Apelit/Prokurorisë dhe Këshillat gjyqësore; inputet nga fokus grupet me përfaqësuesit e Gjykatës së Apelit dhe Prokurorisë, Dhoma e Avokatisë dhe Avokaturës së Shtetit; intervistat me gjyqtarë dhe prokurorë në nivel apeli; si dhe sondazhi me përdoruesit e Gjykatës së Apelit.

Sa i përket ndikimit të projektit, pritet një konsensus sa më i gjerë dhe *miratim potencial nga autoritetet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë* lidhur me sugjerimet për përmirësim të paraqitur nga ekipi i projektit. Një konferencë përfundimtare me pjesëmarrje të këtyre institucioneve gjyqësore dhe një audience më të gjerë të palëve të interesuara, do të jetë vendimtare për sjelljen e një konsensusi dhe miratimi të tillë. Në mënyrë ideale, të katër institucionet gjyqësore të kombinuara mund të dalin me *masa zyrtare për të përmirësuar eficiencën dhe cilësinë e drejtësisë* në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorinë pranë kësaj Gjykate.